



### NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, më datë 18 dhe 19 Korrik 2016, u zhvilluan mbledhjet e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Z.Gentian Sala</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Z.Sami Nezaj</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Z.Gledis Gjipali</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Z.Piro Misha</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Zj.Suela Musta</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Z.Zylyftar Bregu</b>	<b>Anëtar</b>

**Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), pasi mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës, miratoi vendimet e mëposhtme:**

1. Miratimi i rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”. **(Vendim nr.153, datë 18.07.2016);**
2. Miratimi indryshimit të pagesës vjetore për licencë kombëtare transmetimi numerik tokësor audioviziv nga 15,800,000 lekë në masën 9,330,000 lekë. **(Vendim nr.154, datë 18.07.2016);**
3. Miratimin e ndryshimit të faturës me anë të së cilës realizohet vjelja e detyrimeve financiare të operatorëve radiotelevizivë, miratuar me vendimin me nr.07, datë 22.05.2013. **(Vendim nr.155, datë 18.07.2016);**
4. Zëvendësimin e licencës së shoqërisë “**Tv Skampa**” sh.p.k., licencuar për subjektin televiziv privat vendor “**Tv Skampa**”, me licencë për transmetime audiovizive dhe rinovimin e licencës për transmetime audiovizive me afat deri në datën e mbylljes së transmetimeve analoge, në zonën e licencimit të subjektit televiziv privat vendor “**Tv Skampa**”, me kushte teknike të njëjta me kushtet e licencës ekzistuese. **(Vendim nr.156, datë 18.07.2016);**
5. Rinovimin e licencës së shoqërisë “**Radio Travel**” sh.p.k., për subjektin radiofonik privat vendor “**Radio Travel**”. **(Vendim nr.157, datë 18.07.2016);**
6. Rinovimin e licencës së shoqërisë “**Jehona**” sh.p.k., për subjektin radiofonik privat vendor “**Radio Jehona**”. **(Vendim nr.158, datë 18.07.2016);**
7. Rinovimin e licencës së shoqërisë “**Vala 2013**” sh.p.k., për subjektin radiofonik privat vendor “**Radio Spektrum**”. **(Vendim nr.159, datë 18.07.2016);**
8. Miratimin e ndryshimeve në të dhënat e paraqitura për marrjen e licencës së shoqërisë “**Ftoni A**” sh.p.k. dhe rinovimin e licencës së shoqërisë “**Vintage Radio**”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- sh.p.k., për subjektin radiofonik privat vendor “Vintage Radio”. **(Vendim nr.160, datë 18.07.2016);**
9. Rinovimin e licencës së subjektit person fizik **Taulant Pilavi**, për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Klea”. **(Vendim nr.161, datë 18.07.2016);**
  10. Rinovimin e licencës së shoqërisë “**Media Kontakt**” sh.p.k., për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Kontakt”. **(Vendim nr.162, datë 18.07.2016);**
  11. Rinovimin e licencës së shoqërisë “**New Media Vizion**” sh.p.k., për subjektin radiofonik privat vendor “Radio 1”. **(Vendim nr.163, datë 18.07.2016);**
  12. Rinovimin e licencës së shoqërisë “**Tok Media**” sh.p.k., për subjektin radiofonik privat vendor “IN RADIO 105.7” dhe rrëzimin e kërkesës së subjektit për ndryshimin kushteve teknike të licencës.**(Vendim nr.164, datë 18.07.2016);**
  13. Rinovimin e licencës së shoqërisë “**Ora**” sh.a., për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Ora” dhe rrëzimin e kërkesës së subjektit për ndryshimin e kushteve teknike të licencës. **(Vendim nr.165, datë 18.07.2016);**
  14. Rinovimin e licencës së subjektit person fizik **Robert Hoxha** për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Val’ e Kaltër”. **(Vendim nr.166, datë 18.07.2016);**
  15. Rinovimin e licencës së shoqërisë “**Nacional A.H.**” sh.p.k., për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Nacional”. **(Vendim nr.167, datë 18.07.2016);**
  16. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik **Milika Nito**, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Ura Vajgurore”, në njësitë administrative Poshnje dhe Perondi. **(Vendim nr.168, datë 18.07.2016);**
  17. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik **Fitim Goga**, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Goga” në: Njësinë Administrative Cukalat (Bashkia Ura Vajgurore), qytetet dhe fshatrat Hingë, Agim (Njësia Administrative: Poshnjë); Qytetet dhe fshatrat Suk dhe Arapaj (Njësia Administrative: Strum); Qytetet dhe fshatrat Jagodinë (Njësia Administrative Roskovec) dhe ndryshimin e emërimit (logos) të subjektit person fizik Fitim Goga, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor nga “**Tv Kabllor Goga**” në “**Tv Kabllor Erden**”. **(Vendim nr.169, datë 18.07.2016);**
  18. Dhënien e autorizimit, subjektit person fizik **Preng Doda**, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv kabllor Besëlidhja”, **(Vendim nr.170, datë 18.07.2016);**
  19. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “**Top Channel**”sh.a., për ndryshimin e rrjetit numerik privat kombëtar të identifikuar me Nr – 007 K. **(Vendim nr.171, datë 18.07.2016);**
  20. Mosrinovimin e licencës së shoqërisë “**Reçi KGM**” sh.p.k., licencuar me vendimin nr. 484, datë 17.07.2006 të KKRT-së (sot AMA) për subjektin televiziv privat kabllor “Tv me kabëll Mirdita” dhe konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “Reçi KGM” sh.p.k., licencuar me vendimin nr. 484, datë 17.07.2006 të KKRT-së, (sot AMA) për subjektin televiziv privat kabllor “Tv me kabëll Mirdita” **(Vendim nr.172, datë 19.07.2016);**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

21. Pranimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria **“Channel 1” sh.p.k.**, duke vendosur anulimin e vendimit të AMA-s nr. 93, datë 19.05.2016 “Për konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “Channel 1” sh.p.k., licencuar për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Idea”. **(Vendim nr.173, datë 19.07.2016);**
22. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Tele Co Albania” sh.p.k., duke vendosur saktësimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë **“Tele Co Albania” sh.p.k.**, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tele Co Albania”, nga *“Bashkia Tiranë, Fier, Patos, si dhe komunat Levan, Portëz, Qendër, Zharrëz, Mbrostar, Kashar, Paskuqan dhe Farkë”* në zonën *“Njësia administrative Fier dhe Kashar”*. **(Vendim nr.174, datë 19.07.2016);**
23. Kalimin e të drejtave që burojnë nga autorizimi lëshuar për subjektin person fizik Gazmend Doçi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Belshi”, tek shoqëria **“Tv- Best” sh.p.k.** dhe miratimin e ndryshimit të emërimit të subjektit nga **“Tv Belshi”** në **“Tv Best”**. **(Vendim nr.175, datë 19.07.2016);**

**AMA, gjithashtu mori në shqyrtim ankimet administrative ndaj sanksioneve më gjobë të vendosura ndaj subjekteve audiovizive, duke vendosur:**

1. Lënien në fuqi të sanksionit gjobë datë 18.05.2016 ndaj shoqërisë **“TV Klan” sh.a.**, për emisionin “E Diela Shqiptare” në masën 200.000 (dyqindmijë) lekë dhe refuzimin ankimit. **(Vendim nr. 176, datë 19.07.2016);**
2. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 19, datë 09.06.2016 të vendosur ndaj shoqërisë **“Vala 2013” sh.p.k.**, për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Spektrum”, në masën 120 000 (njëqindnjëzetëmijë) lekë. **(Vendim nr. 177, datë 19.07.2016).**
3. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë nr.17, datë 12.05.2016 të vendosur nga grupi i inspektorëve, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, ndaj subjektit person fizik privat Besnik Deliu, për subjektin audioviziv privat **“TV ME KABËLL KAM”**. **(Vendim nr.178, datë 19.07.2016);**
4. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë nr.15, datë 11.04.2016 të vendosur nga grupi i inspektorëve, në masën 2.000.000 (dy milion) lekë, ndaj subjektit shoqërisë **“Tv kabllor Shijaku” sh.p.k.**, për subjektin audioviziv privat **“Tv kabllor Shijaku”**. **(Vendim nr.179, datë 19.07.2016);**
5. Rrëzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr.18, datë 03.06.2016 të vendosur nga grupi i inspektorëve, në masën 2.000.000 (dy milion) lekë, ndaj subjektit person fizik Dritan Xhaçi, për subjektin audioviziv privat **“Tv kabllor Xhaçi”**. **(Vendim nr.180, datë 19.07.2016).**

Tiranë, 20 Korrik 2016

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**